



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 606/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.08.2017, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “MB KURTI” sh.a. në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Blerje Ushqimesh”, me nr. REF-12612-05-11-2017, me fond limit 35,333,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.06.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.

Ankimues: Operatori ekonomik “M.B KURTI” sh.p.k.
Adresa: Lagjia “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Iliaz Ahmeti”, magazinë 1 katëshe, pranë Fabrikës së Qumështit, Lushnje.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës.
Adresa: Sheshi “LIRIA” Durrës.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 12.05.2017 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Blerje Ushqimesh*”, me nr. REF-12612-05-11-2017, me fond limit 35,333,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.06.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.

II.2 Në datën 12.06.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 16.06.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. "MB KURTI" sh.p.k.	26,757,950	lekë pa tvsh	skualifikuar;
2. "LEL" sh.p.k. & "KAZAZI-MEAT" sh.p.k.	27,843,850	lekë pa tvsh	skualifikuar;
3. "NELSA" sh.p.k & "ERDIS" sh.p.k	33,296,150	lekë pa tvsh	skualifikuar;
4. "SEAD-SGS" sh.p.k.	nuk ka paraqitur ofertë		skualifikuar;

II.4. Operatori ekonomik “MB KURTI” sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyet si më poshtë vijon:

“[...] - Ofertuesi M.B.KURTI me vlere te ofertes 26'757'950 leke, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat dhe konkretisht per:

- Per kriterin e kekuar ne DT: Sere per prodhimin e perimeve te fresketa ne pronesi/perdorim te pajisur me : 1. License leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKB).

Per produktin e mesiperme ne rastin kur operatori nuk e ka ne pronesi/perdorim duhet qe te vertetoje me marreveshje bashkepunimi te zyrtarizuar e cila te tregojte qarte lidhjen e zyrtarizuar

midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet te permbaje te dhena te plota si: license, telefon, e-mail,  ebsite, etj., kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi.

Ofertuesi M.B.KURTI per kriterin e mesiperm, ka paraqitur nje Kontrate Furnizimi (Bashkepunimi) me shoqerine "DAJTI PARK 2007" Shpk te dates 02/06/2017 ku ky i fundit do te furnizoje shoqerine "M.B.KURTI" me "perime te fresketa, fruta te fresketa dhe prodhime te tjera bujqesore", por ne asnje rast nuk vertetohet se shoqeria "DAJTI PARK 2007" Shpk te kete Sere prodhimi ne pronesi /perdorim apo te kete ndonje marreveshje te zyrtarizuar me ndonje prodhues sic kerkohet ne dokumentat e tenderit, gjithashtu po per kete kriter, ofertuesi M.B.KURTI, ka paraqitur nje Kontrate Furnizimi (Bashkepunimi) me fermerin Andrea Avrami te dates 05/06/2017 ku ky i fundit do te furnizoje shoqerine "M.B.KURTI" me "perime te fresketa, bostanore, fruta te fresketa dhe prodhime te tjera bujqesore", por ne asnje rast nuk vertetohet se fermeri Andrea Avrami te kete Sere prodhimi ne pronesi /perdorim apo te kete ndonje marreveshje te zyrtarizuar me ndonje prodhues sic kerkohet ne dokumentat e tenderit. KVO vendos qe ofertuesi te mos kualifikohet. [...]"

II.4.1.N  dat n 23.06.2017 operatori ekonomik ankimues "MB KURTI" sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankes  pran  autoritetit kontraktor duke kund rshtuar vendimin e KVO-s  p r skualifikimin e ofert s s  tij n  procedur n e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si m  posht  vijon:

"[...]Ne permbushje te kesaj kerkese kemi dorezuar nje marreveshje furnizimi/bashkepunimi te zyrtarizuar para noterit me nje subjekt prodhues te licensuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKB) License nr.LN -0258-09-2009 leshuar me date 19.08.2016 me afat vlefshmerie pa afat per shoqerine Dajti Park 2007 shpk me kod II.1.C me emertim pershkrues i veprimtarise "Prodhim Primar me Shumice". Kujtojme se referuar detajimit te pasqyruar ne faqen e QKB per kete kategori licensimi nenvizohet :kultivim, grumbullim, manipulim dhe shperndarje me shumice e perime, frutave dhe produkteve bujqesore. Per subjektin prodhues Dajti Park 2007 shpk me te cilin kemi nenshkuar kontrate bashkepunimi/furnizimi jane paraqitur qarte dhe ne menyre te hollesishme vendndodhja, licensa perkatese, ekstrakti i regjistrimit tregtar leshuar me date 11.05.2017 ,me te gjitha informacionin e deklaruar konform ligjit. Ndaj dhe kerkesen e AK per kontrate bashkepunimi/furnizimi me nje prodhues te licensuar shoqeria jone e ka permbushur plotesisht.


Po keshtu, ne plotesim te kesaj kerkese shoqeria jone ka paraqitur nje tjeter kontrate bashkepunim/furnizimi te zyrtarizuar me dokumentat perkatese para noterit, me nje prodhues, person te tatueshem(fermer) Andrea Llazar Avrami, per artikujt perime te fresketa, bostanore, fruta te fresketa dhe prodhime te tjera bujqesore, te licensuar per kultivimin dhe shitjen e artikujve te sipercituar. Po keshtu kujtojme se referuar ligjit, prodhuesit bujqesore pajisen me certificate regjistrimi dhe karte fermeri. Per subjektin prodhues Andrea Llazar Avrami ne kontraten e bashkepunimit kemi paraqitur qarte: Certificate regjistrimi me numer serial 37150272268 me adrese kryesore Divjake me NIPT L 54627551 I me date leshimi 27.10.2015 nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Fier & Karten e fermerit leshuar nga ministria e bujqesise me kod vetiak 210414921247 me date leshimi 14.09.2015. Edhe per subjektin prodhues Andrea Llazar Avrami me te cilin kemi nenshkuar kontrate furnizimi/bashkepunimi jane paraqitur qarte vendndodhja, licensa perkatese me te gjitha informacionin e deklaruar te mjaftueshem per te arsyetuar nga ana AK [...]"

II.4.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 5442/2 Prot. datë 23.06.2017, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “MB KURTI” sh.p.k., duke mos e pranuar asnjë prej pretendimeve të parashtruara në ankesën e tij për procedurën e prokurimit objekt ankimi, me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]Ofertuesi “MB KURTI” shpk për kriterin e mësipërm, ka paraqitur një kontratë furnizimi, (Bashkëpunimi) me shoqërinë “DAJTI PARK 2007” Shpk të datës 02/06/2017, ku ky i fundit merr përsipër furnizimin e shoqërisë “MB KURTI” shpk me “perime të freskëta, fruta të freskëta dhe prodhime të tjera bujqësore”. Referuar Ekstraktit të Regjistrit Tregëtar për të dhënat e subjektit, prodhimi dhe tregëtimi i perimeve të freskëta, frutave të freskëta dhe prodhimeve të tjera bujqësore nuk përfshihet në objektin e aktivitetit të tij. Njëkohësisht ky ofertues ka paraqitur edhe një kontratë furnizimi.(Bashkëpunimi) me fermerin Andrea Avrami të datës 05/06/2017, ku ky i fundit do të furnizojë shoqërinë “MB.KURTI” shpk me “perime të freskëta, bostanore, fruta të freskëta dhe prodhime të tjera bujqësore”. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga ky ofertues vërehet se për fermerin Andrea Avrami nuk janë paraqitur . Liçensë lëshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit QKB; Ekstrakt të Regjistrit Tregëtar për të dhënat e subjektit, ku të vertetohet plotësimi i kriterit objekt ankimi.[...]”

II.5.Në datën 0307.2017 pala ankimuese “MB KURTI” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6.Në datën 12.07.2017 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.13445prot., datë 11.07.2017, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.



III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “MB KURTI” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, me argumentin se: *“[...]Ne permbushje te kesaj kerkese kemi dorezuar nje marreveshje furnizimi/bashkepunimi te zyrtarizuar para noterit me nje subjekt prodhues te licensuar nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKB) License nr.LN -0258-09-2009 leshuar me date 19.08.2016 me afat vlefshmerie pa afat per shoqerine Dajti Park 2007 shpk me kod II.1.C me emertim pershkrues i veprimtarise “Prodhim Primar me Shumice”. Kujtojme se referuar detajimit te pasqyruar ne faqen e QKB per kete kategori licensimi nenvizohet :kultivim, grumbullim, manipulim dhe shperndarje me shumice e perime, frutave dhe produkteve bujqesore. Per subjektin prodhues Dajti Park 2007 shpk me te cilin kemi nenshkruar kontrate bashkepunimi/furnizimi jane paraqitur qarte dhe ne menyre te hollesishme vendndodhja, licensa perkatese, ekstrakti i regjistrit tregtar leshuar me date 11.05.2017 ,me te gjithë informacionin e deklaruar konform ligjit. Ndaj dhe kerkesen e AK per kontrate bashkepunimi/furnizimi me nje prodhues te licensuar shoqeria jone e ka permbushur plotesisht.*

Po kështu, ne plotësim të kësaj kerkese shoqëria jone ka paraqitur një tjetër kontratë bashkëpunim/furnizimi të zyrtarizuar me dokumentat perkatese para noterit, me një prodhues, person të tatueshem(fermer) Andrea Llazar Avrami, për artikujt perime të freskëta, bostanore, fruta të freskëta dhe prodhime të tjera bujqësore, të licensuar për kultivimin dhe shitjen e artikujve të sipercituar. Po kështu kujtojmë se referuar ligjit, prodhuesit bujqësore pajisen me certifikate regjistrimi dhe karte fermeri. Për subjektin prodhues Andrea Llazar Avrami në kontratën e bashkëpunimit kemi paraqitur qarte: *Certifikate regjistrimi me numer serial 37150272268 me adresë kryesore Divjake me NIPT L 54627551 I me datë leshimi 27.10.2015 nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Fier & Kartën e fermerit leshuar nga ministria e bujqësisë me kod vetiak 210414921247 me datë leshimi 14.09.2015. Edhe për subjektin prodhues Andrea Llazar Avrami me të cilin kemi nënshkruar kontratë furnizimi/bashkëpunimi janë paraqitur qarte vendndodhja, licensa perkatese me të gjithë informacionin e deklaruar të mjaftueshem për të arsyetuar nga ana AK”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në pikën (p), të shtojcës 8, “Kapaciteti Teknik”, në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“ Sere për prodhimin e perimeve të freskëta në pronësi/perdorim të pajisur me : 1. License leshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKB). Për produktin e mesiperme në rastin kur operatori nuk e ka në pronësi/perdorim duhet që të vertetojë me marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar e cila të tregojë qarte lidhjen e zyrtarizuar midis ofertuesit dhe prodhuesit ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: license, telefon, email, website, etj., kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi”

III.1.2. Nga verifikimi i kryer nga KPP, për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “MB KURTI” sh.p.k, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.):

- Kontratë furnizimi (Bashkëpunimi), datë 02.06.2017, nr.1795.Rep., nr.1095.Kol., lidhur midis shoqërisë “Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe shoqërisë “MB KURTI” sh.p.k., me objekt “Furnizimi nga pala shoqëria “Dajti Park 2007” sh.p.k. kundrejt palës “MB KURTI” sh.p.k., me artikujt: perime të freskëta, fruta të freskëta dhe prodhime të tjera bujqësore”, bashkëlidhur të cilës ndodhen fotokopje të kartave të identitetit të dy administratorëve të shoqërive palë kontraktore, licensë II.1.C e leshuar nga QKB për subjektin “Dajti Park 2007” sh.p.k., nr.LN-0258-09-2009, si dhe dy ekstrakte të regjistrimit tregtar të dy subjekteve palë kontraktore.
- Kontratë furnizimi (Bashkëpunimi), datë 05.06.2017, nr.1797.Rep., nr.1097.Kol., lidhur midis personit të tatueshem (fermer) “Andrea Avrami” dhe shoqërisë “MB KURTI” sh.p.k., me objekt “Furnizimi nga pala “Andrea Avrami” kundrejt palës “MB KURTI” sh.p.k., me artikujt: perime të freskëta, bostanore, fruta të freskëta dhe prodhime të tjera bujqësore”, bashkëlidhur të cilës ndodhen fotokopje të kartave të identitetit të dy palëve kontraktore, Certifikatë regjistrimi nr.serial 37150272268 leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për personin e tatueshem fermer Andrea Avrami, si dhe Kartë Fermeri, me kod vetiak 210414921247, leshuar nga Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, për fermer Andrea Llazar Avrami.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. [...]”

III.1.4. Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriterit të sipërcituar, KPP konstaton se në asnjë rast nuk arrihet që të vërtetohet disponimi i një sere palësh për prodhimin e perimeve të freskëta nga palët kontraktore furnizuese sikurse ka kërkuar autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi dorëzimi vetëm i ekstraktit tregëtar, licensave ose kartave të fermerit e bën të pamundur verifikimin ose garantimin për pronësinë e serave apo disponimin e kapaciteteve prodhuese/furnizuese për mallrat të cilat do të prokurohen. Vlen të theksohet se autoriteti kontraktor, në kriterin e sipërcituar, nëpërmjet shkurtimit të togfjalëshit “e të tjera” (etj), e ka lënë të hapur dhe në “dorë” të operatorëve ekonomikë që të përzgjedhin dokumentacionin për të dorëzuar, në mënyrë që këta të fundit të garantojnë autoritetin kontraktor për disponueshmërinë e kapaciteteve të kërkuara. KPP gjykon se licensimi për prodhim produktesh bujqësore apo posedimi i kartës së fermerit nuk vërteton automatikisht që palët kontraktore furnizuese “Dajti Park 2007” sh.p.k. dhe (fermer) “Andrea Avrami”, disponojnë kapacitetet sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në pikën (p), të shtojcës 8, “Kapaciteti Teknik”, në dokumentat standarte të tenderit në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Për këtë arsye, dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues nuk mjafton për të përmbushur kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës objekt shqyrtimi. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ankimues “MB KURTI” sh.p.k nuk qëndron.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “MB KURTI” sh.p.k për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Blerje Ushqimesh*”, me nr. REF-12612-05-11-2017, me fond limit 35,333,000 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 05.06.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1196 protokoli Datë 03.07.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha